

20230791514

## МИНИСТЕРСТВО ЗА ЕКОНОМИЈА

Në bazë të nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit për tregti (\*) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/04, 128/06, 63/07, 88/08, 159/08, 20/09, 99/09, 105/09, 115/10, 158/10, 36/11, 53/11, 148/13, 164/13, 97/15, 129/15, 53/16, 120/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 77/21, 215/21, 295/21 dhe 150/22) ministri i Ekonomisë, miratoi

### **RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET MINIMALE-TEKNIKE NË OBJEKTET E SHITJES NË TË CILAT USHTROHET TREGTI ME SHUMICË DHE TREGTI ME PAKICË**

#### Neni 1

Në Rregulloren për plotësimin e rregullores për kushtet minimale-teknike në objektet e shitjes në të cilat ushtrohet tregti me shumicë dhe tregti me pakicë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 290/22), në nenin 20 paragrafi 1 shtohet alineja e re 1 në të cilën thuhet:

„-të ketë së paku 6.000m2 sipërfaqe të përgjithshme të brendshme;“.

Pas paragrafit 3 shtohet paragrafi i ri 4 në të cilin thuhet:

„Në qendrën tregtare (mol) mallrat nga paragrafi 3 i këtij neni duhet të shiten në së paku 10 shitore dhe së paku dy stenda ose kioskë.“.

Paragrafi 4 bëhet paragrafi 5.

#### Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nesërme nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 11-1622/4

7.4.2023

Shkup

Ministër i ekonomisë,  
**Kreshnik Bekteshi, d.v.**